



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2709/2 prot

Datë 05.12.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË
OPERATORIT EKONOMIK ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI
SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*GP Medical AL*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-43438-09-26-2022*, me objekt: “Loti 6 “Stenta të medikuara” me fond limit 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Skualifikimin e operatorit ekonomik “*OES Distrimed*” SHPK në procedurën e mësipërme.

Ankimues: Operatori ekonomik “*GP Medical AL*” SHPK
Adresa: Vorë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “*OES Distrimed*” SHPK
Adresa: Rruga Nikollë Kaçorri, Tiranë, Tiranë.

Në datën 05.11.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2709 prot, e operatorit ekonomik “*GP Medical AL*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. *REF-43438-09-26-2022*, me objekt: “Loti 6 “Stenta të medikuara” me fond limit 103,707,450 (njëqind e tre milion e shtatëqind e

shtatë mijë katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GP Medical AL” SHPK, si dhe kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “OES Distrimed” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “GP Medical AL” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 2709/2022 protokoli, datë 05.12.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyeja e skualifikimit:

“Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori GP MEDICAL AL, rezulton që ky operator nuk plotëson kriteret e kualifikimit konkretisht pikën pikën 6 ku kërkohet Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar), për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, të përkthyer dhe të noterizuar.

Operatori GP Medikal shpk ka paraqitur produktet e prodhuesit Sahajanand Laser Technology Ltd, India. Për artikujt e ofruar të Lot 6, të prodhuesit Sahajanand Laser Technology Ltd rezulton se Operatori ka paraqitur certifikatë CE nr. 17 0528. Në këtë Certifikatë theksohet se ...”me qëllim vendosjen në treg të pajisjevetë Klasës III të pajisjeve që mbulohen nga kjo certifikatë, kërkohet një certifikatë EC Design-Examination pra Certifikatë CE e Egzaminimit të Projektimit sipas Aneksit II (Seksioni IV) të Direktivës Europiane 93/42/EEC”. Artikujt e këtij loti kategorizohen pikërisht në Klasën III, pra më qëllim vendosjen e tyre në treg duhet që certifikata e sipërpërmendur të shoqërohet nga një Certifikatë CE e Egzaminimit të Projektimit. Konstatohet që operatori nuk e ka paraqitur kete certifikate, pra EC Design-Examination pra Certifikatë CE e Egzaminimit të Projektimit. Mungesa e këtij certifikimi nuk garanton sigurinë e

nevojshme për pacientët që do të nënshtrohen procedurave invazive të trajtimit të sëmundjeve koronare ku do të përdoren pajisjet mjekësore objekt të këtij loti.

Për sa më sipër operatori GP MEDICAL AL nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, konkretisht pika 6. Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar), për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, të përkthyer dhe të noterizuar, pasi nuk ka paraqitur certifikate konformiteti CE për artikujt e ofruar.”.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimes “GP Medical Al” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “OES Distrimed” SHPK, pjesmarrës në procedurë.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “OES Distrimed” SHPK, të kriterëve kualifikues si më poshtë vijon:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3. Kapaciteti teknik:

11. Kërkojen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar.

Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « » dhe jo para datës2022, ora ____ : ____.

- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).*
- *Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).*

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa motrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Pretendohet se për të njëjtin artikull ka paraqitur produkte nga dy prodhues të ndryshëm.

6. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC, (të përditësuar), per te gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar ose certifikate FDA, te perkthyer dhe te noterizuar.

7. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij. (të perkthyer dhe te noterizuar)

8. Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të leshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Gjithashtu ankimuesi ngre pretendimin se stenda Biomime ka problem në hapje, sepse designi i saj është që të hapet në qendër dhe pastaj në anë duke krijuar dëmtime në arterian kryesore.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 05.12.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri